VENDIM
Nr.23, datë 25.3.2009

MBI RINOVIMIN E LICENCËS NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT DHE TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE SHOQËRISË KESH SHA

Në mbështetje të nenit 9 dhe 13, pika 1, germa a dhe d të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 5, pika 1 germa b, 13, 14 dhe 16 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 25.3.2009, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. për rinovimin e licencave në aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Me vendimin nr.19, datë 9.3.2009, Bordi i Komisionerëve vendosi fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për rinovimin e licencave në aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike për shoqërinë KESH sh.a.
- Paraqitjen e plotë të dokumentacionit nga KESH sh.a. siç kërkohet nga "Rregullorja për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencat në aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike për shoqërinë KESH sh.a. për një afat 30-vjeçar për aktivitetin e prodhimit dhe 5 vjet për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta